



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Politikën e Jashtme***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 28.01.2021, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Mimi Kodheli - kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 20 dhe 22 janar.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin”, nënshkruar në Tiranë më 14. 01.2009 dhe ratifikuar me ligjin nr. 10094, datë 12.03.2009

**Marrin pjesë:** Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Alket Hyseni, Eglantina Gjermeni, Ervin Bushati, Andrea Marto, Ralf Gjoni, Vasil Sterjovski, Ediola Braha, Zef Shtjefni, Ditmir Bushati, Halit Valteri, Fatmir Velaj dhe Reme Lala.

**Mungojnë:**

Rudina Hajdari dhe Ligoraq Karamelo.

**I ftuar:**

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave

## HAPET MBLEDHJA

**Mimi Kodheli** – Mirëdita!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 28.01.2021.

Në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 20 dhe 22 janar, si dhe shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin”, nënshkruar në Tiranë në 14. 01.2009 dhe ratifikuar me ligjin nr. 10094, datë 12.3.2009. Ne jemi komision për dhënie mendimi, kurse relator është kolegu Ervin Bushati.

Për pikën e dytë, që është i vetmi projektligj që kemi për diskutim, kemi të ftuar zotin Nikolla Lera, drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale në Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave.

Nëse nuk kemi vërejtje për procesverbalet e mbledhjeve të dy datave të sipërpërmendura, kalojmë menjëherë te diskutimi i projektligjit.

Zoti Lera, fjala për ju. Ju lutem, prezantoni shkurtimisht çfarë të mirash sjell ratifikimi i protokollit ndryshues të marrëveshjes.

**Nikolla Lera** - Faleminderit, zonja kryetare!

Qeveria ka prezantuar një ndryshim të protokollit të marrëveshjes së eliminimit të tatimeve të dyfishta me Luksemburgun. Në fakt, ne kemi nënshkruar një marrëveshje me Luksemburgun, e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2009, por në dritën e zhvillimeve të reja gjatë këtyre 5-6 vjetëve të fundit, që kanë të bëjnë me luftën kundër evazionit fiskal, me shkëmbimin e informacionit, me përpjekjet ndërkombëtare për eliminimin e zhvendosjes së bazës së tatimit, pra projekti BEPS, *Base erosion and profit shifting*, të gjitha vendet kanë ndërmarrë iniciativa për rishikimin e marrëveshjeve të tyre. Në këtë kuadër Luksemburgu propozoi që këto nocione të reja dhe filtra të rinj të pasqyrohen edhe në marrëveshjen e lidhur ndërmjet nesh në vitin 2009.

Ata bënë një propozim të parë, të cilin ne e analizuam me shumë kujdes dhe i kthyem përgjigje. Më pas bënë një propozim të dytë, sepse gjithçka ishte në varësi të zhvillimeve ndërkombëtare dhe të rekomandimeve që jepeshin nga BE-ja dhe OECD-ja, në kuadrin e luftës kundër evazionit fiskal dhe shmangies së pagimit të taksave duke alokuar seli të përhershme në vendet me juridiksione, me taksë të ulëta apo me parajsë fiskale. Kjo ka qenë arsyeja pse është zgjatur pak në kohë rinegociimi i kësaj marrëveshjeje.

Gjithashtu, ne u treguam edhe të kujdesshëm, sepse Luksemburgu është qendër financiare dhe donim të shmangnim çdo kërkesë, çdo propozim, i cili mund të krijonte premisa për evadimin e taksave nga Shqipëria në vende të tilla, si Luksemburgu apo vende të tjera, që janë qendra financiare dhe përdoren kryesisht për qëllime të tilla, pra për shmangien e taksave.

Theksoj se dy problemet kryesore që trajtohen në amendimin e kësaj marrëveshjeje janë amendimi i nenit 26, pra shkëmbimi i informacionit, si dhe futja në marrëveshje e koncepteve në kuadrin e BEPS-it, pra të parandalimit të zhvendosjes së taksave nga vendet me juridiksione me taksa më të larta, në vendet me juridiksione me taksa më të ulëta.

Ju e dini që ne jemi në një proces dhe kemi miratuar një sërë ligjesh në këtë kuadër, siç është ligji “Për pronarët përfitues”, ligji “Për shkëmbimin automatik të llogarive” dhe një sërë ligjesh të tjera, të cilat, në fund të fundit, synojnë pikërisht këtë, transparencën në fushën e taksave, shkëmbimin në kohë të informacionit me vendet e tjera për të kalkuluar taksat e rezidentëve të vendeve reciproke në mënyrë të drejtë, moslejimin e zhvendosjes së të ardhurave në vendet ku nuk paguhet taksa apo ku tarifatat janë më të ulëta dhe një sërë problemesh të tjera të cilat synojnë, sikurse thashë, rritjen e transparencës në pakësim. Pikërisht këto amendime që i janë bërë marrëveshjes me Luksemburgun synojnë këtë gjë.

Faleminderit, të nderuar!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

**Ervin Bushati** – Faleminderit, kryetare!

Faleminderit edhe zotit Lera për shpjegimin!

Më vjen mirë, në fakt, që në një sërë marrëveshjesh që kemi bërë për shmangien e tatimit të dyfishtë vjen edhe kjo me Dukatit e Luksemburgut, gjithmonë në shpresën e një rritjeje inkrementale që pastaj të kemi mundësinë të paraqitemi edhe te disa vende që kanë vërtet vlerë, si Greqia apo Italia, Gjermania, ku të kemi me të vërtetë...

**Nikolla Lera** – Marrëveshjet janë të viteve '91, '92, '93; janë shumë të vjetra.

**Ervin Bushati** – ...mundësinë që edhe qytetarët shqiptarë që kanë punuar atje, të fillojnë të përfitojnë nga këto marrëveshje.

Ashtu siç u tha edhe në të gjithë shpjegimin e gjerë nga zoti Lera, është amenduar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Dukatit të Madh të Luksemburgut për eliminimin e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, krijon një bazë të plotë ligjore për trajtimin tatimor të individëve ose personave juridikë shqiptarë apo luksemburgas, të cilët kanë aktivitete biznesi apo të

ardhurat të tjera, që janë objekt i legjislacioni tatimor të të dyja shteteve. Për sa u përket efekteve tatimore, nuk ka.

Meqë mbas kaq kohësh po bëjmë një takim në sallë drejtpërdrejt, unë kam një sugjerim për mbledhjet e komisionet që bëjmë online. U kemi thënë edhe ministrive të tjera, do të ishte mirë për ne që ministritë të kishin një prezantim më të unifikuar edhe të standardizuar, me një kamera full Hd ose në një sallë, ku ju ndjeheni më mirë dhe më komodë, me një baner nga mbrapa, ku të shkruhet “Ministria e Financave”, sepse në të gjitha mbledhjet, ndryshe prezantohet një drejtori, ndryshe një tjetër, ndonjëherë duken si ambiente shtëpie, ndoshta nuk janë të tilla.

**Nikolla Lera** – Edhe mund të ndodhë.

**Mimi Kodheli** – Sepse punohet nga shtëpia.

**Nikolla Lera** – Po

**Ervin Bushati** - Ju keni një sallë shumë të mirë. Unë jam shprehur edhe herë tjetër, megjithatë po përfitoj nga rasti.

**Nikolla Lera** – Jeni shumë korrekt.

**Ervin Bushati** - Jam kryqtar, çfarë të bëj.

**Nikolla Lera** – Unë jam ushtar.

**Ervin Bushati** - Unë jam kryqtar, ti je ushtar, por them tjetër gjë.

**Nikolla Lera** – Gjithmonë kur më është kërkuar të jem prezent në komisione, kam qenë online nga zyra.

**Ervin Bushati** - Kjo historia “na ra interneti, nuk kemi internet” nga Ministria e Financave, nuk shkon.

**Nikolla Lera** – Ke plotësisht të drejtë, por duhet biseduar, që të standardizohet mënyra e prezantimit.

**Ervin Bushati** - Këtë po e them unë pra, këtë këshillë po e jap unë.

Po ma jep këshillë mua?

**Nikolla Lera** – Jo, jo. Po ju sugjeroj që duhet folur me...

**Andor Shameti** - Zoti Bushati, po harxhon kohë me zotin Lera.

**Ditmir Bushati** – Zoti Bushati, kemi ministrin për Marrëdhënie me Parlamentit. Zoti Lera, përveçse se është koleg që e kemi dëgjuar në disa seanca, nuk ka ...

**Ervin Bushati** – Ju nga Ministra e Financave, që ndan lekët për të gjithë dhe thoni: “na ra interneti dhe s’kemi internet të mirë”.

**Nikolla Lera** – Unë do të bëj një memo për titullarët e institucionit lidhur me këtë vërejtje të Komisionit të Jashtëm

**Ervin Bushati** - Unë kam disa herë, në disa komisione që e ngre këtë vërejtje. Të ngrihet një komision standardizimi i kësaj procedure, sepse të gjithë ministrinë bëjnë transmetime të ndryshme.

**Mimi Kodheli** – Unë dua të them që tashmë është shumë vonë.

Është e rëndësishme që ne në detyrën tonë të jemi seriozë dhe të mund ta mbështesim Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në të gjitha rastet që qeveria dhe ministria vetë ka nevojë për të kaluar sa më shpejt, sidomos marrëveshjet dhe ratifikimet e protokolleve, që janë pothuajse diçka rutinë.

Përpara se të falënderoj kolegun Lera, përpara se ta hedhim në votim më lejoni që në emrin tuaj të uroj ministren Gjermani për pozicionin për të cilin është votuar jo më larg se dje, është bërë kryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës.

**Eglantina Gjermani** – Shumë faleminderit, kryetare!

**Mimi Kodheli** – Tinës i uroj më të mirën dhe sigurisht që përcjell atje edhe zërin e të gjitha grave të emancipuara të Shqipërisë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

E hedhim votim.

Kush është dakord me projektligjin?

Faleminderit kolegut Sterjoski në mënyrë të veçantë.

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Le të shënohet në procesverbal që është dakord edhe nënkryetari Gjoni.

Neni 1?

Shoh që nuk ka as kundër as abstenime.

Miratohet.

Neni 2.

Edhe një herë në tërësi projektligjin.

Atëherë konsiderohet i miratuar.

Faleminderit!

**MBYLLET MBLEDHJA**